



Delësi-tizazno

Nr. 1-37
Gr.

Data 14.03.2022
Datum



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq-Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.21.02.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Nazlije Shala, Sami Ahmeti, Ajshe Haliti Pllana dhe Linda Sadiku

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkryetar i Komunës, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit, drejtorët komunal dhe përf.e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Kuvendit komunal
4. Plotësim ndryshimi i Rregullores nr.-I-36, e dt.25.02.2009, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëminë e Tregtisë, Hotelierisë, Zejtarisë dhe shërbimeve të tjera në territorin e Komunës së Obiliqit
5. Plotësim ndryshimi i Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Komunën e Obiliqit
6. Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2021
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 4 vota për dhe 2 vota abstenim.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 4 vota për dhe 2 vota kundër.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Siç e dini edhe ju bazuar në LVL-në, neni 40, pika 2, alinea 2, Kuvendi komunal harton dhe miraton planin vjetor të punës, e cila është një ndër kompetencat themelore të Kuvendit komunal. Anëtarët e Komisionit kanë punuar në draft planin e punës dhe më njoftuan se është lëshuar një gabim teknik te pika f) te faqja 1, ku është përshkruar nga LVL-ja, duhet të hiqet sepse tani zgjedhja e Kryetarit dhe zëvendës Kryetarit nuk bëhet përmes Kuvendit.

Sami Ahmeti – Ne realisht nuk kemi diçka kundër dhe jemi për me dërgue në Kuvend këtë draft, pastaj të bisedojmë për vërejtjet tona.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim Planin e punës të Kuvendit komunal për vitin 2022.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga DEFZH-ja, për plotësim ndryshimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëminë e Tregtisë, Hotelierisë, Zejtarisë dhe shërbimeve të tjera në territorin e Komunës së Obiliqit. Rregullorja në fjalë duhet të harmonizohet me ligjet në fuqi dhe të dalë në debat publik.

Sami Ahmeti – Realisht unë e kam lexuar Rregulloren dhe jam dakord që të shkoj në Kuvend, pastaj gjithçka të bëhet në debat publik dhe ne si grup parlamentar jemi pro.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal daljen në debat publik për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr.-I-36, e dt.25.02.2009, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëminë e Tregtisë, Hotelierisë, Zejtarisë dhe Shërbimeve të tjera në territorin e Komunës së Obiliqit.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Po ashtu, kemi kërkesën nga Drejtoria e administratës për daljen në debat publik për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Komunën e Obiliqit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal daljen në debat publik për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Komunën e Obiliqit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraprakisht e falenderoj Kryetarin dhe Ekzekutivin që ka bërë një punë të palodhshme duke pasë parasysh sfidat e shumta që kanë qenë gjatë vitit të kaluar kur edhe ne jemi ballafaq me pandeminë dhe shumë gjëra të tjera.

Sami Ahmeti – Ne propozojmë që kjo pikë e rendit të ditës të ketë afat dhe mundësi që të shqyrtohet deri në mbledhjen e radhës të Kuvendit komunal sepse është një raport shumë voluminoz dhe aq sa kam pasë mundësi me pa është shumë i shkapërderdhur. Për këtë arsye ne propozojmë që kjo pikë e rendit të ditës të ketë mundësinë që të shqyrtohen dokumentet dhe të shtyhet për mbledhjen e radhës të Kuvendit komunal.

Kryesuesja - Raporti vjetor i punës së Kryetarit nuk votohet, por vetëm njoftohet Kuvendi komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 4 vota për dhe 2 vota kundër ia rekomanduan Kuvendit Komunal për shqyrtim Raportin vjetor të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2021.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga kompania “Berisha Group” Sh.p.k. për shëndrrimin e parcelave bujqësore në parcela ndërtimore, ZK Milloshevë. Mendoj se kjo kërkesë duhet ti drejtohet DPUKP-së.

Sami Ahmeti – Realisht këto kërkesa që po vijnë edhe prej mandatit të kaluar, por edhe në këtë mandat, po vijnë shumë të pakompletuara. Në një komunitet siç është Millosheva, vendi i dytë me banorë pas Obiliqit po vijnë kërkesa me dëshirë që secili ka dëshirë me bë diçka për veten dhe me shtue pasurinë e vetë. Megjithatë, pa e pyet komunitetin këto nuk janë në rregullë. Ne duhet të mësohemi që kur të vijnë kërkesat, të vijnë me një petition që të paktën qytetarët ai aktivitet nuk i pengon sepse kemi raste që në Milloshevë edhe pse janë bërë peticione kundër dy fenomeneve aty, ato prapë vazhdojnë punën. Ne si rrjedhojë jemi kundër që kërkesat e tilla të shkojnë dhe të aprovohen.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 4 vota për dhe 3 vota kundër ia rekomanduan Drejtorisë së bujqësisë dhe Kuvendit komunal për shqyrtim kërkesën nr.-XVI-3002, të dt.02.02.2022, nga kompania “Berisha Group” Sh.p.k. për shëndrrimin e parcelave bujqësore në parcela ndërtimore, ZK Milloshevë.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga N.SH. “Kastrioti” për ndihmë financiare

Enver Gashi – Pasi është këtu drejtoresha e financave, mund të na sqaroj se a është kjo çështje e rregulluar me ligj që me i bë këto kompensime.

Ibush Mjekiqi – Mendoj se kjo kërkesë duhet të shqyrtohet në mbledhjen e radhës të Kuvendit komunal, por që duhet të jetë e harmonizuar me Ligjin për rimëkëmbjen ekonomike dhe të shihet mundësia se si mund ta ndihmojmë këtë kompani, por edhe kompanitë tjera sipas nevojës.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitatit për Politikë dhe Financa unanimisht ia rekomanduan DSHPE-së dhe Kuvendit komunal për shqyrtim kërkesën nga N.SH. “Kastrioti” për ndihmë financiare.

Mbledhja përfundoi në ora 10:19’

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesuesja e KPF

Vlora Mjekiqi Kabashi